REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 49/1 Prot. Tiranë, më 04 02 2020

VENDIM SENATI

Nr 3, Datë 04.02.2020

MBI NDRYSHIMET NË RREGULLOREN E DOKTORATËS

Në respekt të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të tij, në konsiderim të Statutit të UBT-së dhe në zbatim të tij, si dhe bazuar mbi VKM nr. 879, datë 18.12.2019, si dhe në Vendimin e Rektorati të UBT-së, nr. 1, dt. 16.01.2020, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 04/02/2020,

V E N D O S I:

1. **Të reflektojë ndryshimet në rregulloren e doktoratës si më poshtë:**

NENI 4

Shtuar pika 7, (pas pikës 6)

Programet e studimeve të ciklit të tretë përmbajnë aktivitete të formimit të thelluar teorik duke zhvilluar, së paku dy lëndë, të cilat përfundojnë me provim para një Komisioni të Doktoratave në departament dhe që sigurojnë, së bashku 30 kredite. Dy lëndët do të jenë (a) lëndë bazë dhe (b) lëndë karakterizuese (bazuar në VKM nr. 879 datë 18.12.2019).

Modifikuar pika 11

Numri i doktorantëve, që udhëheq çdo anëtar i personelit akademik, brenda të njëjtës periudhë, është:

a) jo më shumë se 3 veta për personelin akademik me titull "Profesor";
b) jo më shumë se 2 veta për personelin akademik me titull "Prof. asociuar";
c) jo më shumë se 2 veta kur personeli akademik është me gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete të njohura perëndimore, si dhe USA, Kanada.

NENI 5

Modifikuar pika 2. A

1. Programi i doktoratës duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar:
   a) **Planin e lëndëve teorike të detyruara** (Lëndëve bazë dhe karakterizuese, si më lartë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

NENI 6

Modifikuar pika 7

1. Pas miratimit nga Senati, secili program studimi i ciklit të tretë (i ri ose i riorganizuar) bashkë me dokumentacionin që përmban: a) Programin e ristrukturuar të doktoratës sipas formatit të përgatitur nga Rektorati, (b) Syllabuset e lëndëve teorike bazë dhe karakterizuese, të nënshkruar nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UBT-së, i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin për licensimin e secilit Program studimi të ciklit të tretë (bazuar në VKM-në 873, dt. 18.12.2019).
2. Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, UBT-ja duhet të paraqesë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin, kërkesën për hapjen e tyre, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
   1. Dokumentin, në të cilin përcaktohet fusha shkencore dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të tretë.e shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës nga fakulteti për interesin që paraqet kjo fushë së bashku me syllbuset e lëndëve bazë dhe karakterizuese.

Shtuar në pikën 8, pas gërmës h

Vetëm pasi merr liçensimin për programin dhe numrin e kuotave nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë bëhet regjistrimi në regjistrat e doktoratave të fakulteteve dhe universitetit.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi, Zëvendësrektori për Kërkimin Shkencor, Dega e KKSHP-së, dekanët e fakulteteve dhe përgjegjësit e departamenteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Bari Musabelliu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
REKTORATI

Nr 99 Prot. Tiranë, më 16.01. 2020

VENDIM REKTORATI

Nr 1, Datë 16.01.2020

MBI NDRYSHIMET NË RREGULLOREN E DOKTORATËS

Në respekt të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të tij, në konsiderim të Statutit të UBT-së dhe në zbatim të tij, si dhe bazuar mbi VKM nr. 879, datë 18.12.2019, Rektorati i UBT-së në mbledhjen e tij të datës 16/01/2020,

VENDOSI:

1. **Të reflektojë ndryshimet në rregulloren e doktoratës si më poshtë:**

NENI 4

Shtuar pika 7, (pas pikës 6)

Programet e studimeve të ciklit të tretë përmbajnë aktivitete të formimit të thelluar teorik duke zhvilluar, së paku dy lëndë, të cilat përfundojnë me provim para një Komisioni të Doktoratave në departament dhe që sigurojnë, së bashku 30 kredite. Dy lëndët do të jenë (a) lëndë bazë dhe (b) lëndë karakterizuese (bazuar në VKM nr. 879 datë 18.12.2019).

Modifikuar pika 11

Numri i doktorantëve, që udhëheq çdo anëtar i personelit akademik, brenda të njëjtës periudhë, është:

a) jo më shumë se 3 veta për personelin akademik me titull "Profesor";
b) jo më shumë se 2 veta për personelin akademik me titull "Prof. asociuar";
c) jo më shumë se 2 veta kur personeli akademik është me gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete të njohura perëndimore, si dhe USA, Kanada.

NENI 5

Modifikuar pika 2. A

1. Programi i doktoratës duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar:
   a) **Planin e lëndëve teorike të detyruara** (Lëndëve bazë dhe karakterizuese, si më lartë)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

NENI 6

Modifikuar pika 7

1. Pas miratimit nga Senati, secili program studimi i ciklit të tretë (i ri ose i riorganizuar) bashkë me dokumentacionin që përmban: a) Programin e ristrukturuar të doktoratës sipas formatit të përgatitur nga Rektorati, (b) Syllabuset e lëndëve teorike bazë dhe karakterizuese, të nënshkruar nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UBT-së, i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin për licensimin e secilit Program studimi të ciklit të tretë (bazuar në VKM-në 873, dt. 18.12.2019).
2. Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, UBT-ja duhet të paraqesë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin, kërkesën për hapjen e tyre, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
   1. Dokumentin, në të cilin përcaktohet fusha shkencore dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të tretë,e shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës nga fakulteti për interesin që paraqet kjo fushë së bashku me syllbuset e lëndëve bazë dhe karakterizuese.

Shtuar në pikën 8, pas gërmës h

Vetëm pasi merr liçensimin për programin dhe numrin e kuotave nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë bëhet regjistrimi në regjistrat e doktoratave të fakulteteve dhe universitetit.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi, Zëvendësrektori për Kërkimin Shkencor, Dega e KKSH, dekanët e fakulteteve dhe përgjegjësit e departamenteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Bari MUSABELLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1322/1 Prot. Tiranë, më 02/07/2018

VENDIM SENATI

Nr. 26, Datë 02.07.2018

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE - DOKTORATË

Në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 112, dt. 23.02.2018 "Përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"", Statutin e UBT-së dhe Vendimin e Rektoratit nr. 27, dt. 01.06.2018, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2018

VENDOSI:

1. Të miratohet Rregullorja e Ciklit të Tretë të Studimeve – Doktoratë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zëvendësrektori për Shkencën, departamentet, dekanatet, komisionet e Doktoratës në fakultete dhe Zyra e Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Projekteve të UBT-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Bari Musabelliu

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

RREGULLORE BAZË E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE (DOKTORATË) NË UBT

(Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë» si dhe në VKM-në 112, dt. 23/02/2018)

M I R A T O I

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Bari MUSABELLIU

Tiranë, 2018

PJESA E PARË

PROCEDURAT E PROPOZIMIT, MIRATIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE

Neni 1
Baza ligjore

Rregullorja mbi Organizimin e studimeve të ciklit të tretë për përfitimin e gradës shkencore "Doktor" në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) bazohet në:

- Ligjin Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 112, datë 23. 02. 2018.
- Udhëzimi e Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, nr. 52, dt. 03.12. 2015
- Standardet për akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të tretë.
- Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.
- Kodi e Etikës së UBT-së.

Neni 2
Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka për qëllim:

1. Zbatimin e programit të studimeve të ciklit të tretë (Doktoratë), i cili mundëson marrjen e gradës shkencore "Doktor" në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

2. Trajtimin kronologjik të objektivave, ndarjen e përgjegjësive, pranimin, regjistrimin, kërkimin, mbrojtjen e tezës dhe fitimin e gradës shkencore "Doktor".

Neni 3
Objektivat dhe fusha e veprimit të rregullores

Programi i studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", në UBT ka si objektiva:

1. Kualifikimin dhe edukimin e kërkuesve në nivel të lartë kërkimor në përputhje me parimet e njohura shkencore dhe etike të UBT-së, të sanksionuara me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe në VKM-në, 112, dt. 23.02.2018.

2. Kryerjen nga doktorantët të projektit të tyre të kërkimit shkencor dhe mbrojtjen e tij para Jurisë për fitimin e gradës shkencore "Doktor",
3. Fusha e veprimit të rregullores është cikli i tretë i studimeve "Doktoratë" në të gjitha njësitë kryesore të UBT-së që nga aplikimi deri në përfundim të programit kërkimor.

Neni 4
Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Programet e studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", janë programe me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor për përgatitjen e tezës së doktoratës, rezultatet dhe mbrojtja e suksesshme e së cilës do të çojë në fitimin e gradës shkencore "Doktor".
2. Studimet e ciklit të tretë, zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë/njësisë kryesore, ose me kohë të zgjatur në ato raste, kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
   (Ligji i Arsimit të lartë, 80/2015, neni 79, pika 2 dhe VKM 112, kreu I, pika 1).
3. Në studimet e ciklit të tretë, pranohen kandidatët që kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve me nivelin e pikëve 80, ose me note mesatare 8 e lartë, dhe kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave" ose një diplomë ekuivalente me të. Regjistrimi bëhet pranë njësisë bazë.
4. Studimet e ciklit të tretë zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. (Ligji i arsimit të lartë, neni 77, pika 4). Në raste të veçanta, për arsye objektive të justifikueshme, me propozim nga njësitë bazë dhe miratim nga dekanatet, afati mund të shtyhet me dy periudha nga 6 muaj.
5. Programet e studimeve të ciklit të tretë, organizohen si rregull brenda një projekti të madh kërkimor-shkencor e zhvillimor për këto studime dhe realizohen në koordinim me aktivitete të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësisë bazë, njësive kryesore dhe UBT-së. Këto njësi aplikojnë për financim pranë AKKSHI, apo pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare (neni 79, pika 1 e Ligjit AL. 80/2015). Në rastet e aplikantëve me statusin e personelit akademik të brendshëm, programet e ciklit të tretë mund të mbështeten në burimet e brendshme të Institucionit.
6. Programet e studimit të ciklit të tretë, mund të jenë edhe ndërdisiplinore, ose dhe të përbashkëta në nivel të njësive bazë, në nivel të njësive kryesore të UBT-së, apo edhe në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, ku njësë e procesit kërkimor mund të zhvillohet pranë institucioneve bashkëpunuese.

(neni 79, pika 3 e ligjit 80/2015).

7. Programet e studimeve të ciklit të tretë, mund të përmbajnë aktivitete të formimit të thelluar teorik, bazuar në rekomandimet përkatëse të udhëheqësit apo grupit kërkimor, për të përvetësuar metodologjitë e kërkimit dhe teknikave operative specifike etj.

8. Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup mësimor përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti është në vartësi të projekteve kërkimore brenda njësive bazë. Për kryerjen e studimeve të ciklit të tretë studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte te tjera, apo dhe të vetëfinancohet (Ligji AL, neni 79, pikat 4 dhe 5).

9. Në rastet kur një pjesë e studimeve të ciklit të tretë, zhvillohen në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanada, bashkëudhëheqësi në këto vende pritëse mund të jetë edhe me gradën "PhD/Doktor"(ligji AL 80/2015, neni 79, pika 6).

10. Programet e ciklit të tretë, drejtohen nga personeli akademik me titull "Profesor i asociuar" ose "Profesor", të cilët mund të udhëheqin një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë "Profesor" ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është i angazhuar (ligji AL 80/2015, neni 79, pika 6).

11. Numri i doktorantëve, që udhëheq çdo anëtar i personelit akademik, brenda të njëjtës periudhë, është:

    a) jo më shumë se 7 veta për personelin akademik me titull "Profesor"

    b) jo më shume se 5 veta për personelin akademik me titull "Prof. asociuar"

    c) jo më shume se 3 veta kur personeli akademik "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" janë angazhuar me kohë të pjesshme (VKM 112, kreu I, pika 3.

    d) jo më shumë se 2 veta kur personeli akademik është me gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete të njohura perëndimore, USA, Kanada.

12. Kriter pranimi në një program të ciklit të tretë, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht (Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 78, pika 3) e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në përputhje me udhëzimin nr. 52, dt. O3.12. 2015 të Ministrit përgjegjëse për arsimin.

13. Studentët doktorantë, të cilët i kanë kryer studimet e larta jashtë vendit dhe kanë dhënë në vendin e shkollimit provimin e gjuhës angleze në një prej testeve të njohura ndërkombëtarisht dhe të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, ose kanë fituar një diplomë të një programi studimi në një nga pesë

gjuhët e lartpërmendura, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri (neni 78, pika 3 e ligjit 80/2015).

14. Grada shkencore "Doktor" fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së dizertacionit në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të tretë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor sipas kritereve dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin e arsimit të lartë (VKM 112 kreu 1. Pika 2) dhe në këtë rregullore.

Neni 5

Përmbajtja e programit

1. Programi i studimeve të ciklit të tretë organizohet në mënyrë që të garantojë:
   a) mundësitë për një kërkim shkencor të pavarur në bashkëpunim me drejtuesin/udhëheqësin dhe në raste të veçanta dhe me kërkues të tjerë;
   b) pjesëmarrjen aktive në grupe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
   c) punën kërkimore, e cila është e lidhur ngushtë me punën e Doktoratës;
   d) përpilimin e tezës së Doktoratës, bazuar në punën kërkimore-shkencore.
2. Programi i doktoratës duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar:
   a) **Planin e kërkimit shkencor** (fusha bazë e kërkimit shkencor, objektivat kryesore të kërkimit, koha dhe vendi i realizimit të kërkimeve metodat bazë që do të përdoren në realizimin e kërkimit etj.);
   b) **Planin e aktiviteteve krijuese** të studentëve të doktoratës dhe mënyrën e monitorimit të ecurisë së tyre (koha dhe numri i referimeve në njësinë bazë, i botimeve shkencore dhe i pjesëmarrjes në konferenca shkencore, etj.);
   c) **Planin e angazhimit** të studentëve të doktoratës në aktivitete ndihmëse të procesit akademik në grupet mësimore dhe njësitë bazë përkatëse (mbështetje për studentët, udhëheqje diplomash, praktika mësimore dhe profesionale, etj.).

Neni 6

Propozimi për hapjen e programeve të ciklit të tretë

1. Plani kërkimor i doktorantit përcaktohet në vartësi të projekteve kërkimore të njësisë bazë, por ai mund të përballojë edhe vetë shpenzimet duke përfituar financime nga subjekte të tjera apo edhe të vetëfinancohet (neni 79, pika 4 e ligjit 80/2015).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

2. Nisma propozuese për hapjen, apo riorganizimin e programeve të studimeve të ciklit të tretë, dhe numri i studentëve doktorantë bëhet nga njësitë bazë me grupet mësimore-kërkimore, njësitë kryesore, dhe depozitohet tek zv/dekani përgjegjës për studimet e ciklit të tretë, që e relaton në dekanat për vendimmarrje.

3. Njësia propozuese (njësia bazë/fakulteti duhet të organizojë vlerësimin e brendshëm të programit të ciklit të tretë, i cili duhet të shqyrtohet brenda 15 ditëve nga komisioni i Gradës Shkencore "Doktor" (më poshtë KGSHD).

4. Në cdo rast duhet të plotësohen kriteret dhe standardet e mëposhtme:
   a) ka personel të mjaftueshëm në kërkim, të personelit akademik të brendshëm me tituj akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar" si dhe gradën "PhD", të fituar në universitete të njohura perëndimore, USA e Kanada (standardet shtetërore, I.1. kriteri 6).
   b) ka struktura operative dhe kërkimore për analizat dhe aktivitetet e parashikuara në metodikën e studimeve, burime financiare mbështetëse të mjaftueshme për vazhdueshmërinë dhe kryerjen e të gjitha fazave të kërkimit të doktoratës.
   c) ka përcaktuar mënyrat e raportimeve në njësinë bazë sipas planit trevjeçar të zhvillimit dhe progres-raportet për çdo vit për verifikimin e veprimtarisë kërkimore të studentëve të ciklit të tretë.

5. Zv./dekani përgjegjës për studimet e ciklit të tretë, i paraqet Dekanatit propozimin e njësisë bazë/njësisë kryesore për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të tretë, ose propozimin për riorganizimin e një programi ekzistues.

6. Dekanati brenda 1 (një) muaji nga data e paraqitjes së propozimit të programit, e shqyrton nëse përputhet me kërkesat ligjore të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Dekani i njësisë kryesore e përcjell në Rektorat, i cili ka detyrimin e përcjelljes së propozimit në Senatin Akademik.

7. Pas miratimit nga Senati, secili program studimi i ciklit të tretë (i ri ose i riorganizuar) bashkë me dokumentacionin përkatës të nënshkruar nga Dekani i njësisë kryesore dhe Rektori i UBT-së i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin për procedura të mëtejshme.

8. Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, UBT-ja duhet të paraqesë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin kërkesën për hapjen e tyre, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

a) Dokumentin, në të cilin përcaktohet fusha shkencore dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të tretë, e shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës nga njësia kryesore për interesin që paraqet kjo fushë. Programi i studimit të ciklit të tretë duhet të paraqitet sipas rregullave të parashikuara në statutin e UBT-së.

b) Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;

c) Tarifën e studimit për çdo student (e argumentuar), si dhe burime të tjera financimi për studimet e ciklit të tretë, nëse ka të tilla. Në këtë kontekst tarifa e studimeve do të jetë në përputhje me specifikat dhe propozimet e njësisë kryesore, por jo më pak se 100 mijë lekë në vit;

d) Parashikimin për numrin maksimal të studentëve që mund të regjistrohen çdo vit në programet e ciklit të tretë, përcaktuar nga njësia bazë në vartësi nga projcktct kërkimore, numër, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se tre;

e) Personelin akademik që do të mbulojë sipas rasteve, module të veçanta dhe udhëheqjen e doktorantëve sipas titullit apo gradës shkencore dhe numrit përkatës të studentëve për çdo udhëheqës.

f) Të dhënat për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, njësinë bazë që drejton administrativisht programin e studimeve të ciklit të tretë edhe kur kjo është ndër-disiplinore, ndër-departamentore, etj.

g) Marrëveshje të institucionit të arsimit të lartë, së paku me një universitet të një vendi të zhvilluar, që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe studentëve të studimeve të ciklit të tretë, si dhe realizim të projekteve kërkimore të përbashkëta;

h) Njësinë, apo njësitë bazë propozuese të programit të studimit të ciklit të tretë, që garantojnë ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme, ndërtimore e laboratorike për zhvillimin e programit;

i) Modelin e diplomës së doktoratës;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

PJESA E DYTË

PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES DHE PRANIMIT TË KANDIDATËVE FITUES

Neni 7
Kushtet dhe Kriteret e pranimit

2. Të drejtën e aplikimit për programin e studimeve të ciklit të tretë në UBT e kanë të gjithë kandidatët që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve dhe kanë fituar diplomën universitare "Master i shkencave", ose një diplomë ekuivalente me të (si "DIND").
3. Në programin e studimeve të ciklit të tretë pranohen kandidatët që kanë mbaruar ciklin e parë me notën mesatare 7 e lart dhe ciklin e dytë të studimeve me notën mesatare 8 e lart. (neni 78, pika 1 e Ligjit AL 80/2015 dhe Standartet shtetërore të cilësisë, standarti I.3, kreu 1).
4. Studenti që aplikon për tu pranuar në programine studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, (ligji 80/2015, neni 78, pika 3) të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin C1, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 52, të Ministrit përgjegjës për arsimin, pika 1 e 3.
5. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja bëhet sipas tabelës së testeve ndërkombëtare të njohura në Shqipëri, në referencë të pikëve të këtyre testeve, duke shërbyer si standart për njohjen e gjuhëve të huaja dhe që i bashkëlidhen udhëzimit nr. 52, dt.3. 12. 2015.
6. Kandidati që aplikon për tu pranuar në programet e studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë çertifikimet dhe rezultatet e testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve të huaja, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se dy vjet nga koha e lëshimit të tyre. (udhëzimi nr. 52, dt.3. 12. 2015, pika 4).
7. Dokumenti i njohjes së gjuhëve të huaja mund të jetë një certifikate, diplomë apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testimeve ndërkombëtare (udhëzimi i mësipërm, pika 5).
8. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e lartpërmendura, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj (ligji 80/2015, neni 78, pika 3).
9. Njësia kryesore propozon kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë, të cilat diskutohen në njësitë bazë dhe miratohen nga dekanatet sipas specifikave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

të njësive bazë, në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë. Këto kritere bëhen publike nga UBT-ja dhe i përcillen QSHA-së dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

10. Kandidati përpara se të pranohet në programin e studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë marrë informacion të detajuar lidhur me:

    a) kohëzgjatjen e programit të studimit të doktoratës;

    b) kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti përpara paraqitjes në provimin e Doktoratës;

    c) mbështetjen që institucioni dhe udhëheqja i sigurojnë studentit veçanërisht informacionin lidhur me përgatitjen e tezës së Doktoratës për mbrojtje;

    d) modalitetet e verifikimit të veprimtarisë shkencore, veçanërisht kërkesat lidhur me përgatitjen e tezës së doktoratës, të cilat jepen në fund të kësaj rregulloreje;

    e) informacionin që studenti duhet të gjejë në faqen zyrtare të UBT-së.

11. Njoftimi për hapjen e programit së studimeve të ciklit të tretë, numrin e vendeve të disponueshme, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, publikohen jo më pak se një muaj përpara datës së konkurimit në faqen elektronike të UBT-së.

Neni 8
Procedura e aplikimit

1. Kandidatët konkurrojnë me dosje që dorëzohen tek zv/dekani i programit të studimeve të ciklit të tretë dhe dosja duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:

    a. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të ciklit të tretë;

    b. CV personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla;

    c. Kopje të noterizuara të diplomës universitare, "Master i shkencave", ose një diplomë ekuivalente me të, së bashku me listën e notave;

    d. Fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit/pasaportë;

    e. Dy fotografi;

    f. Dy rekomandime nga persona me titull akademik;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

g. Një deklaratë ku ai pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare, lidhur me koston e studimeve sipas përcaktimeve të bëra nga instancat e UBT-së;

h. Një propozim ku përcaktohet fusha me interes e kandidatit për ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë dhe udhëheqësin shkencor;

i. Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje e noterizuar);

j. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurrim (2000 lekë);

2. Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e sipërpërmendura nuk merren në konsideratë.
3. Dokumentet e dorëzuara në UBT nuk i kthehen mbrapsht aplikantit. Ato ruhen për gjashtë muaj e më pas arshivohen.
4. Dokumentacioni i aplikantit nuk mund të ndryshohet apo plotësohet pas dorëzimit.

Neni 9

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga njësia bazë/kryesore e UBT-së, përgjegjëse për organizimin e programit të studimeve të ciklit të tretë, mbi bazën e propozimit të njësisë bazë përkatëse. Kandidatët nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UBT, kanë përparësi.
2. Vlerësimi i kandidatëve që aplikojnë për të filluar studimet e ciklit të tretë në njësitë kryesore në UBT duhet të bëhet sipas mesatares të notave dhe pikëve të fituara gjatë prezantimit të projektit kërkimor dhe kritereve të tjera të përcaktuara nga njësia kryesore përkatëse.
3. Dosja e kandidatit kontrollohet nga zv/dekani i programit të studimeve të ciklit të tretë për plotësinë e dokumentacionit në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe i përcillet njësisë bazë përkatëse.
4. Pranë njësisë bazë/njësisë kryesore ngrihet komisioni "*ad-hoc*", me tre deri pesë anëtarë, kryetar i të cilit është përgjegjësi i njësisë bazë, nëse ka titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Në raste të tjera kryetar i komisionit është një anëtar i njësia bazë me titujt e lartëpërmendur dhe përgjegjësi i njësisë bazë është anëtar i komisionit "*ad-hoc*".
5. Komisioni "*ad-hoc*" i njësisë bazë pas seleksionimit, bazuar në dosjen e aplikantit, realizon intervistën me kandidatin, ku mund të diskutohet fusha dhe tema e kërkimit.
6. Një javë pas mbylljes së aplikimeve, komisionet *ad – hoc*, listat e kandidatëve fitues, ia paraqesin njësisë bazë, e cila miraton ose jo listën e kandidatëve fitues.

me udhëheqësit përkatës dhe ja përcjell Dekanatit të njësisë kryesore.

7. Dekanati, brenda dy javësh miraton listat e kandidatëve fitues me udhëheqësit përkatës dhe shpall listën përfundimtare të fituesve dhe jo fituesve, brenda një javë.
8. Dekani përcakton afatet e ankimimit të kandidatëve të shpallur jo fitues dhe shqyrton çdo ankimim duke u shprehur me vendim, i cili është përfundimtar.
9. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e njësisë kryesore përgjegjëse për programin përkatës të ciklit të tretë për një periudhë një javore.
10. Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk rregjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e studimeve të ciklit të tretë dhe në vend të tij rregjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare brenda një afati tre ditor.
11. Kandidatët atashohen pranë njësisë bazë përkatëse. Dokumentacioni i aplikimit depozitohet në sekretarinë e njësisë bazë dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.

Neni 10
Korniza kohore

1. Studimet e ciklit të tretë gjasin jo më pak se tri vite dhe jo më shumë se pesë vite akademike (Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 77, pika 4). Në përfundim të këtyre studimeve lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".
2. Periudha e kontraktuar mund të zgjatet për shkak të mungesave të arsyeshme, sëmundjeve afatgjata apo rrethanave të tjera të paparashikuara. Kandidati ka të drejtën e zgjatjes së periudhës së kontratës deri dy herë nga 6 muaj.
3. Miratimi/vendimi i kësaj zgjatjeje jepet nga Dekani i njësisë kryesore, bazuar në kërkesën me shkrim të bërë nga kandidati dhe propozimin e njësisë bazë.
4. Në rast se dizertacioni nuk paraqitet për fillim procedure të mbrojtjes edhe brenda afatit të tejzgjatur (pa justifikim bindës), Dekanati me propozim të njësisë bazë ndërpret vazhdimin e doktoraturës.
5. Në rastet, si p.sh. për shkak të thyerjes së etikës, mungesës së progresit të punës kërkimore në afate, apo ndryshimeve sinjifikative të projektit kërkimor, njësia bazë mund ti propozojë Dekanatit, që kandidati të ndërpresë programin përpara përfundimit, vendim të cilin e miraton Dekani.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

PJESA E TRETË

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 11
Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së kërkimit

1. Udhëheqësi në bashkëpunim me studentin, përgatit metodologjinë e kërkimit dhe planin e zhvillimit, të cilat diskutohen në grupet mësimore-kërkimore në njësinë bazë ku është atashuar.
2. Ky plan zhvillimi duhet të përfshijë:
   a. Një përshkrim të plotë të projektit dhe detyrave të kërkimit;
   b. Projekt plan - progresin për përfundimin e komponentit kërkimor;
   c. Ndonjë plan për qëndrimin në universitete të tjera, institucione kërkimore brenda apo jashtë vendit;
   d. Projekt planin e botimeve dhe referimeve sipas kërkesave për përfundimin e komponentit kërkimor (referuar VKM-112, viti 2018).
3. Raportet e progresit përgatiten nga doktorantët në bashkëpunim me udhëheqësin/t e tyre dhe shqyrtohen dhe miratohen çdo vit akademik në referimet vjetore të doktorantëve në njësinë bazë.

Neni 12
Udhëheqja dhe ecuria e studimeve

1. Puna për kryerjen e tezës së doktoratës duhet të kryhet nën drejtimin individual të udhëheqësit me titull "Profesor", "Profesor i asociuar", ose dhe me bashkëudhëheqës me gradën shkencore "Doktor" ("PhD") të marrë në universitete të njohura në BE, SHBA, Kanada.

2. Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur është rasti i ofrimit të programit të studimeve të ciklit të tretë nga më shumë se një njësi universitare) siguron/jnë që studentët të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre.
3. Njësia bazë përgjegjëse duhet të përcaktojë menjëherë një udhëheqës të ri (ose dy) dhe t'ia propozojë dekanatit, në rastet kur:
   a. Udhëheqësi kryesor nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit ose kur do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme;

b. Marrëdhënia student-udhëheqës nuk funksionon mirë dhe duhet të ndryshojë me kërkesë të studentit ose të udhëheqësit të tij;

4. Zëvendësimi udhëheqësit bëhet brenda dhe jo më vonë se viti i dytë i kërkimit shkencor, me qëllim që ecuria e procesit të mos cënohet.
5. Në të gjitha rastet, studenti duhet të ketë vetëm një pikë të identifikuar kontakti, që duhet të jetë udhëheqësi kryesor i tij/saj. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studenti duhet të dijë se kush do të jetë personi që do ta zëvendësojë.
6. Udhëheqësi dhe studenti duhet të mbajnë kontakte të rregullta. Udhëheqësi është përgjegjës për vazhdimësinë akademiko-kërkimore të studentit dhe duhet të mundësojë pjesëmarjen e rregullt të tij në grupin kërkimor.
7. Takimet ndërmjet udhëheqësve dhe doktorantëve duhet të jenë të dokumentuara gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit në njësinë bazë.
8. Çdo vit duhet të bëhet vlerësimi i studentit nëpërmjet referimeve të hapura në njësinë bazë/grupin mësimor-kërkimor. Në çdo rast njësia bazë/grupi jep konkluzionet e vlerësimit, të cilat mund të përfshijnë dhe pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin e kandidatit nga Doktorata.

Neni 13
Baza didaktike dhe mbështetja teknike

Njësia bazë duhet tu garantojë studentëve të pranuar në programin e Doktoratës:

a) Kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik dhe kërkimor;

b) Vënien në dispozicion të bibliotekës shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike, si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së;

c) mbështetjen teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor;

d) bazë laboratorike të mjaftushme për kërkimet që kanë të nevojshme procedura laboratorike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

PJESA E KATËRT

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I STUDENTËVE

Neni 14
Teza e Doktoratës

1. Vlerësimi përfundimtar i studentëve të Doktoratës duhet të bazohet mbi të gjitha në një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij.

2. Rezultati i kërkimit duhet të paraqitet dhe duhet të ketë formatin e një teze disertacioni. Teza duhet të jetë një pjesë e pavarur e punës shkencore dhe me nivel të lartë akademik në lidhje me formulimin e argumenteve të kërkimit, bazën konceptuale, aspektet teorike, metodologjinë, dokumentimin dhe saktësinë e tij, përdorimin e literaturës dhe prezantimin e punës gjatë mbrojtjes para Jurisë.

3. Teza duhet të kontribuojë në zhvillimin e njohurive të reja teorike kundrejt disiplinës përkatëse dhe të ketë një standard akademik, i cili të justifikojë publikimin si pjesë e literaturës në fushën përkatëse.

4. Rezultati i kërkimit mund të jetë edhe kumulativ, me jo më pak se 3 artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare **me faktor impakti (*Thomson & Reuters*) me koficient mbi 1** (standartet shtetërore të cilësisë, II-5, kriteri 4)

5. Në këtë rast teza duhet të përmbajë dhe një kapitull, i cili të përmbledhë dhe të sistemojë problemet dhe konkluzionet e kërkimit të paraqitura në punët e veçanta dhe që në të njëjtën kohë dokumentojnë koherencën e tezës. Kandidati duhet të jetë autori i vetëm i kësaj pjese të tezës.

6. Studenti është i detyruar të ruajë të dhënat e kërkimit në përputhje me udhëzimet dhe rregulloren e studimeve të UBT-së, duke disponuar të gjitha fletoret me shënime, që ka mbajtur gjatë kryerjes së fazave të kërkimit.

7. Në publikimet shkencore, që janë pjesë e punës së Doktoratës do të përdoret përkatësia e UBT-së dhe mirëkuptimi/marrëveshja për autorësitë midis studentit, udhëheqësit dhe bashkëpunëtorëve të tjerë po të ketë.

8. Kriteret bazë që duhet të plotësojë studenti përpara mbrojtjes së dizertacionit janë: (sipas VKM 112, dt. 23.02.2018).

   a. të ketë realizuar si autor i parë ose dhe i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat, të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) **në ose me** të paktën një nga vëndet e BE, OECD, G-20, të pranuara në

bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceding", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

b. të ketë botuar së paku 3 (tre) artikuj shkencore në revista shkencore, 2 nga të cilat të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vëndeve të BE-së, OECD-së dhe G20-tës, me bord editorial, ku së paku në njërin të jetë autor i parë dhe në tjetrin edhe autor i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi.

c. të ketë realizuar 3 (tre) referime në njësinë bazë, përveç referimit të parë, që i takon metodikës ose metodologjisë së studimit. Në referimin e tretë, përveç të dhënave të vitit të tretë duhet dhe përmbledhja e rezultateve për të gjithë kërkimin.

d. të gjitha referimet dhe botimet duhet të pasqyrojnë aspekte të punës kërkimore që i përkasin zhvillimit dhe realizimit të planit të doktoratës.

e. të ketë përgatitur dhe dorëzuar në departament dizertacionin së bashku me një përmbledhje/autoreferatin të miratuara paraprakisht dhe të firmosura nga udhëheqësi shkencor.

9. Dizertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet ti përmbahet formatit të kërkuar nga Standartet e Cilësisë dhe Rregullores e Studimeve të ciklit të tretë të UBT-së, mbi modelin e tezës, e cila duhet të ketë një përmbledhje (2000-4000 fjalë), në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian, në format të shtypur dhe elektronik, CD.(VKM 112, kriteri 7).

Neni 15
Dorëzimi i tezës dhe ngritja e Jurisë

1. Sapo kandidati i Doktoratës është gati për t'u vlerësuar teza e tij, dosja e doktoratës me kopjet e tezës dorëzohet pranë drejtusit të njësisë kryesore, së bashku me një kërkesë për fillimin e procedurës së mbrojtjes, të firmosur nga kandidati dhe udhëheqësi. Nëse dosja depozitohet, ajo nuk mund të tërhiqet para se të vendoset mbrojtja publike e tezës para Jurisë.

2. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e dorëzimit të dosjes në Dekanat, ja përcjell dosjen për vlerësim njësisë bazë. Pas vlerësimit dhe propozimit të Jurisë me 8 (tetë) kandidatë nga njësia bazë, dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

SPL ERROR : Incomplete Session by time out

POSITION : 0x353e84 (3489412)

SYSTEM : h6iwsim/os_hook

LINE : 1603

VERSION : SPL 5.90 05-15-2014

ERROR CODE : 11-1112

UNIVERSITETI BUJQESORE "SHQIPËRISË" TIRANË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1322/1 Prot. Tiranë, më 02/07/2018

VENDIM SENATI

Nr. 26, Datë 02.07.2018

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE - DOKTORATË

Në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-në nr. 112, dt. 23.02.2018 "Përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"", Statutin e UBT-së dhe Vendimin e Rektoratit nr. 27, dt. 01.06.2018, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.07.2018

VENDOSI:

1. Të miratohet Rregullorja e Ciklit të Tretë të Studimeve – Doktoratë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zëvendësrektori për Shkencën, departamentet, dekanatet, komisionet e Doktoratës në fakultete dhe Zyra e Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Projekteve të UBT-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Bari Musabelliu

Adresa: Rruga "Paisi Vodica
Kodër-Kamëz, Tiranë

www.ubt.edu.al

Agricultural University of Tirana

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

RREGULLORE BAZË E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE (DOKTORATË) NË UBT

(Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë» si dhe në VKM-në 112, dt. 23/02/2018)

M I R A T O I

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Bari MUSABELLIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQESOR - TIRANE

Tiranë, 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQESOR - TIRANE

PJESA E PARË

PROCEDURAT E PROPOZIMIT, MIRATIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE

Neni 1
Baza ligjore

Rregullorja mbi Organizimin e studimeve të ciklit të tretë për përfitimin e gradës shkencore "Doktor" në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT) bazohet në:

- Ligjin Nr. 80/2015 «Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 112, datë 23. 02. 2018.
- Udhëzimi e Ministrit të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, nr. 52, dt. 03.12. 2015
- Standardet për akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të tretë.
- Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.
- Kodi e Etikës së UBT-së.

Neni 2
Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka për qëllim:

1. Zbatimin e programit të studimeve të ciklit të tretë (Doktoratë), i cili mundëson marrjen e gradës shkencore "Doktor" në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

2. Trajtimin kronologjik të objektivave, ndarjen e përgjegjësive, pranimin, regjistrimin, kërkimin, mbrojtjen e tezës dhe fitimin e gradës shkencore "Doktor".

Neni 3
Objektivat dhe fusha e veprimit të rregullores

Programi i studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", në UBT ka si objektiva:

1. Kualifikimin dhe edukimin e kërkuesve në nivel të lartë kërkimor në përputhje me parimet e njohura shkencore dhe etike të UBT-së, të sanksionuara me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe në VKM-në, 112, dt. 23.02.2018.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

2. Kryerjen nga doktorantët të projektit të tyre të kërkimit shkencor dhe mbrojtjen e tij para Jurisë për fitimin e gradës shkencore "Doktor",
3. Fusha e veprimit të rregullores është cikli i tretë i studimeve "Doktoratë" në të gjitha njësitë kryesore të UBT-së që nga aplikimi deri në përfundim të programit kërkimor.

Neni 4
Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Programet e studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", janë programe me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor për përgatitjen e tezës së doktoratës, rezultatet dhe mbrojtja e suksesshme e së cilës do të çojë në fitimin e gradës shkencore "Doktor".
2. Studimet e ciklit të tretë, zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë/njësisë kryesore, ose me kohë të zgjatur në ato raste, kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
   (Ligji i Arsimit të lartë, 80/2015, neni 79, pika 2 dhe VKM 112, kreu I, pika 1).
3. Në studimet e ciklit të tretë, pranohen kandidatët që kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve me nivelin e pikëve 80, ose me note mesatare 8 e lartë, dhe kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave" ose një diplomë ekuivalente me të. Regjistrimi bëhet pranë njësisë bazë.
4. Studimet e ciklit të tretë zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. (Ligji i arsimit të lartë, neni 77, pika 4). Në raste të veçanta, për arsye objektive të justifikueshme, me propozim nga njësitë bazë dhe miratim nga dekanatet, afati mund të shtyhet me dy periudha nga 6 muaj.
5. Programet e studimeve të ciklit të tretë, organizohen si rregull brenda një projekti të madh kërkimor-shkencor e zhvillimor për këto studime dhe realizohen në koordinim me aktivitete të kërkimit të grupeve kërkimore brenda njësisë bazë, njësive kryesore dhe UBT-së. Këto njësi aplikojnë për financim pranë AKKSHI, apo pranë institucioneve të tjera financuese kombëtare dhe ndërkombëtare (neni 79, pika 1 e Ligjit AL. 80/2015). Në rastet e aplikantëve me statusin e personelit akademik të brendshëm, programet e ciklit të tretë mund të mbështeten në burimet e brendshme të Institucionit.
6. Programet e studimit të ciklit të tretë, mund të jenë edhe ndërdisiplinore ose dhe të përbashkëta në nivel të njësive bazë, në nivel të njësive kryesore të UBT-së, apo edhe në bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë, ku pjesë e procesit kërkimor mund të zhvillohet pranë institucioneve bashkëpunuese.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

(neni 79, pika 3 e ligjit 80/2015).

7. Programet e studimeve të ciklit të tretë, mund të përmbajnë aktivitete të formimit të thelluar teorik, bazuar në rekomandimet përkatëse të udhëheqësit apo grupit kërkimor, për të përvetësuar metodologjitë e kërkimit dhe teknikave operative specifike etj.

8. Numri i doktorantëve në përbërje të secilit grup mësimor përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti është në vartësi të projekteve kërkimore brenda njësive bazë. Për kryerjen e studimeve të ciklit të tretë studenti mund të përfitojë edhe financime nga subjekte te tjera, apo dhe të vetëfinancohet (Ligji AL, neni 79, pikat 4 dhe 5).

9. Në rastet kur një pjesë e studimeve të ciklit të tretë, zhvillohen në një institucion të arsimit të lartë të vendeve anëtarë të Bashkimit Evropian, SHBA-ve dhe Kanada, bashkëudhëheqësi në këto vende pritëse mund të jetë edhe me gradën "PhD/Doktor"(ligji AL 80/2015, neni 79, pika 6).

10. Programet e ciklit të tretë, drejtohen nga personeli akademik me titull "Profesor i asociuar" ose "Profesor", të cilët mund të udhëheqin një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë "Profesor" ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është i angazhuar (ligji AL 80/2015, neni 79, pika 6).

11. Numri i doktorantëve, që udhëheq çdo anëtar i personelit akademik, brenda të njëjtës periudhë, është:

    a) jo më shumë se 7 veta për personelin akademik me titull "Profesor"

    b) jo më shume se 5 veta për personelin akademik me titull "Prof. asociuar"

    c) jo më shume se 3 veta kur personeli akademik "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" janë angazhuar me kohë të pjesshme (VKM 112, kreu I, pika 3.

    d) jo më shumë se 2 veta kur personeli akademik është me gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete të njohura perëndimore, USA, Kanada.

12. Kriter pranimi në një program të ciklit të tretë, është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht (Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 78, pika 3) e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në përputhje me udhëzimin nr. 52, dt. 03.12. 2015 të Ministrit përgjegjëse për arsimin.

13. Studentët doktorantë, të cilët i kanë kryer studimet e larta jashtë vendit dhe kanë dhënë në vendin e shkollimit provimin e gjuhës angleze në një prej testeve të njohura ndërkombëtarisht dhe të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, ose kanë fituar një diplomë të një programi studimi në një nga pesë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

gjuhët e lartpërmendura, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri (neni 78, pika 3 e ligjit 80/2015).

14. Grada shkencore "Doktor" fitohet pas mbrojtjes me sukses të tezës së dizertacionit në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të tretë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor sipas kritereve dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin e arsimit të lartë (VKM 112 kreu 1. Pika 2) dhe në këtë rregullore.

Neni 5

Përmbajtja e programit

1. Programi i studimeve të ciklit të tretë organizohet në mënyrë që të garantojë:
   a) mundësitë për një kërkim shkencor të pavarur në bashkëpunim me drejtuesin/udhëheqësin dhe në raste të veçanta dhe me kërkues të tjerë;
   b) pjesëmarrjen aktive në grupe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
   c) punën kërkimore, e cila është e lidhur ngushtë me punën e Doktoratës;
   d) përpilimin e tezës së Doktoratës, bazuar në punën kërkimore-shkencore.
2. Programi i doktoratës duhet të pasqyrojë në mënyrë të detajuar:
   a) **Planin e kërkimit shkencor** (fusha bazë e kërkimit shkencor, objektivat kryesore të kërkimit, koha dhe vendi i realizimit të kërkimeve metodat bazë që do të përdoren në realizimin e kërkimit etj.);
   b) **Planin e aktiviteteve krijuese** të studentëve të doktoratës dhe mënyrën e monitorimit të ecurisë së tyre (koha dhe numri i referimeve në njësinë bazë, i botimeve shkencore dhe i pjesëmarrjes në konferenca shkencore, etj.);
   c) **Planin e angazhimit** të studentëve të doktoratës në aktivitete ndihmëse të procesit akademik në grupet mësimore dhe njësitë bazë përkatëse (mbështetje për studentët, udhëheqje diplomash, praktika mësimore dhe profesionale, etj.).

Neni 6

Propozimi për hapjen e programeve të ciklit të tretë

1. Plani kërkimor i doktorantit përcaktohet në vartësi të projekteve kërkimore të njësisë bazë, por ai mund të përballojë edhe vetë shpenzimet duke-përfituar financime nga subjekte të tjera apo edhe të vetëfinancohet (neni 79, pika 4 e ligjit 80/2015).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

2. Nisma propozuese për hapjen, apo riorganizimin e programeve të studimeve të ciklit të tretë, dhe numri i studentëve doktorantë bëhet nga njësitë bazë me grupet mësimore-kërkimore, njësitë kryesore, dhe depozitohet tek zv/dekani përgjegjës për studimet e ciklit të tretë, që e relaton në dekanat për vendimmarrje.

3. Njësia propozuese (njësia bazë/fakulteti duhet të organizojë vlerësimin e brendshëm të programit të ciklit të tretë, i cili duhet të shqyrtohet brenda 15 ditëve nga komisioni i Gradës Shkencore "Doktor" (më poshtë KGSHD).

4. Në cdo rast duhet të plotësohen kriteret dhe standardet e mëposhtme:
   a) ka personel të mjaftueshëm në kërkim, të personelit akademik të brendshëm me tituj akademikë "Profesor" dhe "Profesor i asociuar" si dhe gradën "PhD", të fituar në universitete të njohura perëndimore, USA e Kanada (standardet shtetërore, I.1. kriteri 6).
   b) ka struktura operative dhe kërkimore për analizat dhe aktivitetet e parashikuara në metodikën e studimeve, burime financiare mbështetëse të mjaftueshme për vazhdueshmërinë dhe kryerjen e të gjitha fazave të kërkimit të doktoratës.
   c) ka përcaktuar mënyrat e raportimeve në njësinë bazë sipas planit trevjeçar të zhvillimit dhe progres-raportet për çdo vit për verifikimin e veprimtarisë kërkimore të studentëve të ciklit të tretë.

5. Zv./dekani përgjegjës për studimet e ciklit të tretë, i paraqet Dekanatit propozimin e njësisë bazë/njësisë kryesore për hapjen e programit të ri të studimit të ciklit të tretë, ose propozimin për riorganizimin e një programi ekzistues.

6. Dekanati brenda 1 (një) muaji nga data e paraqitjes së propozimit të programit, e shqyrton nëse përputhet me kërkesat ligjore të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Dekani i njësisë kryesore e përcjell në Rektorat, i cili ka detyrimin e përcjelljes së propozimit në Senatin Akademik.

7. Pas miratimit nga Senati, secili program studimi i ciklit të tretë (i ri ose i riorganizuar) bashkë me dokumentacionin përkatës të nënshkruar nga Dekani i njësisë kryesore dhe Rektori i UBT-së i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për arsimin për procedura të mëtejshme.

8. Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, UBT-ja duhet të paraqesë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin kërkesën për hapjen e tyre, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin, në të cilin përcaktohet fusha shkencore dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të tretë, e shoqëruar me relacionin shpjegues përkatës nga njësia kryesore për interesin që paraqet kjo fushë. Programi i studimit të ciklit të tretë duhet të paraqitet sipas rregullave të parashikuara në statutin e UBT-së.

b) Afatet kohore të realizimit të programit të studimit;

c) Tarifën e studimit për çdo student (e argumentuar), si dhe burime të tjera financimi për studimet e ciklit të tretë, nëse ka të tilla. Në këtë kontekst tarifa e studimeve do të jetë në përputhje me specifikat dhe propozimet e njësisë kryesore, por jo më pak se 100 mijë lekë në vit;

d) Parashikimin për numrin maksimal të studentëve që mund të regjistrohen çdo vit në programet e ciklit të tretë, përcaktuar nga njësia bazë në vartësi nga projektet kërkimore, numër, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se tre;

e) Personelin akademik që do të mbulojë sipas rasteve, module të veçanta dhe udhëheqjen e doktorantëve sipas titullit apo gradës shkencore dhe numrit përkatës të studentëve për çdo udhëheqës.

f) Të dhënat për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, njësinë bazë që drejton administrativisht programin e studimeve të ciklit të tretë edhe kur kjo është ndër-disiplinore, ndër-departamentore, etj.

g) Marrëveshje të institucionit të arsimit të lartë, së paku me një universitet të një vendi të zhvilluar, që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe studentëve të studimeve të ciklit të tretë, si dhe realizim të projekteve kërkimore të përbashkëta;

h) Njësinë, apo njësitë bazë propozuese të programit të studimit të ciklit të tretë, që garantojnë ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme, ndërtimore e laboratorike për zhvillimin e programit;

i) Modelin e diplomës së doktoratës;

PJESA E DYTË

PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES DHE PRANIMIT TË KANDIDATËVE FITUES

Neni 7
Kushtet dhe Kriteret e pranimit

2. Të drejtën e aplikimit për programin e studimeve të ciklit të tretë në UBT e kanë të gjithë kandidatët që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve dhe kanë fituar diplomën universitare "Master i shkencave", ose një diplomë ekuivalente me të (si "DIND").
3. Në programin e studimeve të ciklit të tretë pranohen kandidatët që kanë mbaruar ciklin e parë me notën mesatare 7 e lart dhe ciklin e dytë të studimeve me notën mesatare 8 e lart. (neni 78, pika 1 e Ligjit AL 80/2015 dhe Standartet shtetërore të cilësisë, standarti I.3, kreu 1).
4. Studenti që aplikon për tu pranuar në programine studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë njohje të njërës prej pesë gjuhëve të huaja si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, (ligji 80/2015, neni 78, pika 3) të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin C1, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 52, të Ministrit përgjegjës për arsimin, pika 1 e 3.
5. Klasifikimi i aftësive gjuhësore dhe niveleve të njohjes së gjuhëve të huaja bëhet sipas tabelës së testeve ndërkombëtare të njohura në Shqipëri, në referencë të pikëve të këtyre testeve, duke shërbyer si standart për njohjen e gjuhëve të huaja dhe që i bashkëlidhen udhëzimit nr. 52, dt.3. 12. 2015.
6. Kandidati që aplikon për tu pranuar në programet e studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë çertifikimet dhe rezultatet e testimeve ndërkombëtare për nivelet e njohjes së gjuhëve të huaja, të cilat i përkasin një periudhe jo më vonë se dy vjet nga koha e lëshimit të tyre. (udhëzimi nr. 52, dt.3. 12. 2015, pika 4).
7. Dokumenti i njohjes së gjuhëve të huaja mund të jetë një certifikate, diplomë apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin për ofrimin e testimeve ndërkombëtare (udhëzimi i mësipërm, pika 5).
8. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e lartpërmendura, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj (ligji 80/2015, neni 78, pika 3).
9. Njësia kryesore propozon kriteret e pranimit në programet e ciklit të tretë, të cilat diskutohen në njësitë bazë dhe miratohen nga dekanatet sipas specifikave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

të njësive bazë, në përputhje me standartet shtetërore të cilësisë. Këto kritere bëhen publike nga UBT-ja dhe i përcillen QSHA-së dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin.

10. Kandidati përpara se të pranohet në programin e studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë marrë informacion të detajuar lidhur me:

    a) kohëzgjatjen e programit të studimit të doktoratës;

    b) kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti përpara paraqitjes në provimin e Doktoratës;

    c) mbështetjen që institucioni dhe udhëheqja i sigurojnë studentit veçanërisht informacionin lidhur me përgatitjen e tezës së Doktoratës për mbrojtje;

    d) modalitetet e verifikimit të veprimtarisë shkencore, veçanërisht kërkesat lidhur me përgatitjen e tezës së doktoratës, të cilat jepen në fund të kësaj rregulloreje;

    e) informacionin që studenti duhet të gjejë në faqen zyrtare të UBT-së.

11. Njoftimi për hapjen e programit së studimeve të ciklit të tretë, numrin e vendeve të disponueshme, kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes, publikohen jo më pak se një muaj përpara datës së konkurimit në faqen elektronike të UBT-së.

Neni 8
Procedura e aplikimit

1. Kandidatët konkurrojnë me dosje që dorëzohen tek zv/dekani i programit të studimeve të ciklit të tretë dhe dosja duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:
    a. Kërkesën e kandidatit drejtuar njësisë bazë, përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e studimeve të ciklit të tretë;
    b. CV personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla;
    c. Kopje të noterizuara të diplomës universitare, "Master i shkencave", ose një diplomë ekuivalente me të, së bashku me listën e notave;
    d. Fotokopje të noterizuar të kartës së identitetit/pasaportë;
    e. Dy fotografi;
    f. Dy rekomandime nga persona me titull akademik;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

g. Një deklaratë ku ai pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare, lidhur me koston e studimeve sipas përcaktimeve të bëra nga instancat e UBT-së;

h. Një propozim ku përcaktohet fusha me interes e kandidatit për ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë dhe udhëheqësin shkencor;

i. Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje e noterizuar);

j. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurrim (2000 lekë);

2. Aplikimet që nuk përmbajnë dokumentet e sipërpërmendura nuk merren në konsideratë.

3. Dokumentet e dorëzuara në UBT nuk i kthehen mbrapsht aplikantit. Ato ruhen për gjashtë muaj e më pas arshivohen.

4. Dokumentacioni i aplikantit nuk mund të ndryshohet apo plotësohet pas dorëzimit.

Neni 9

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve

1. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga njësia bazë/kryesore e UBT-së, përgjegjëse për organizimin e programit të studimeve të ciklit të tretë, mbi bazën e propozimit të njësisë bazë përkatëse. Kandidatët nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në UBT, kanë përparësi.

2. Vlerësimi i kandidatëve që aplikojnë për të filluar studimet e ciklit të tretë në njësitë kryesore në UBT duhet të bëhet sipas mesatares të notave dhe pikëve të fituara gjatë prezantimit të projektit kërkimor dhe kritereve të tjera të përcaktuara nga njësia kryesore përkatëse.

3. Dosja e kandidatit kontrollohet nga zv/dekani i programit të studimeve të ciklit të tretë për plotësinë e dokumentacionit në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje dhe i përcillet njësisë bazë përkatëse.

4. Pranë njësisë bazë/njësisë kryesore ngrihet komisioni "*ad-hoc*", me tre deri pesë anëtarë, kryetar i të cilit është përgjegjësi i njësisë bazë, nëse ka titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar". Në raste të tjera kryetar i komisionit është një anëtar i njësia bazë me titujt e lartëpërmendur dhe përgjegjësi i njësisë bazë është anëtar i komisionit "*ad-hoc*".

5. Komisioni "*ad-hoc*" i njësisë bazë pas seleksionimit, bazuar në dosjen e aplikantit, realizon intervistën me kandidatin, ku mund të diskutohet fusha dhe tema e kërkimit.

6. Një javë pas mbylljes së aplikimeve, komisionet *ad – hoc*, listat e kandidatëve fitues, ia paraqesin njësisë bazë, e cila miraton ose jo listën e kandidatëve fitues

me udhëheqësit përkatës dhe ja përcjell Dekanatit të njësisë kryesore.

7. Dekanati, brenda dy javësh miraton listat e kandidatëve fitues me udhëheqësit përkatës dhe shpall listën përfundimtare të fituesve dhe jo fituesve, brenda një javë.
8. Dekani përcakton afatet e ankimimit të kandidatëve të shpallur jo fitues dhe shqyrton çdo ankimim duke u shprehur me vendim, i cili është përfundimtar.
9. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e njësisë kryesore përgjegjëse për programin përkatës të ciklit të tretë për një periudhë një javore.
10. Në rast se një kandidat tërhiqet ose nuk rregjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e studimeve të ciklit të tretë dhe në vend të tij rregjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare brenda një afati tre ditor.
11. Kandidatët atashohen pranë njësisë bazë përkatëse. Dokumentacioni i aplikimit depozitohet në sekretarinë e njësisë bazë dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.

Neni 10
Korniza kohore

1. Studimet e ciklit të tretë gjasin jo më pak se tri vite dhe jo më shumë se pesë vite akademike (Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 77, pika 4). Në përfundim të këtyre studimeve lëshohet diploma e gradës shkencore "Doktor".
2. Periudha e kontraktuar mund të zgjatet për shkak të mungesave të arsyeshme, sëmundjeve afatgjata apo rrethanave të tjera të paparashikuara. Kandidati ka të drejtën e zgjatjes së periudhës së kontratës deri dy herë nga 6 muaj.
3. Miratimi/vendimi i kësaj zgjatjeje jepet nga Dekani i njësisë kryesore, bazuar në kërkesën me shkrim të bërë nga kandidati dhe propozimin e njësisë bazë.
4. Në rast se dizertacioni nuk paraqitet për fillim procedure të mbrojtjes edhe brenda afatit të tejzgjatur (pa justifikim bindës), Dekanati me propozim të njësisë bazë ndërpret vazhdimin e doktoraturës.
5. Në rastet, si p.sh. për shkak të thyerjes së etikës, mungesës së progresit të punës kërkimore në afate, apo ndryshimeve sinjifikative të projektit kërkimor, njësia bazë mund ti propozojë Dekanatit, që kandidati të ndërpresë programin përpara përfundimit, vendim të cilin e miraton Dekani.

PJESA E TRETË

KËRKIMI SHKENCOR

Neni 11
Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së kërkimit

1. Udhëheqësi në bashkëpunim me studentin, përgatit metodologjinë e kërkimit dhe planin e zhvillimit, të cilat diskutohen në grupet mësimore-kërkimore në njësinë bazë ku është atashuar.
2. Ky plan zhvillimi duhet të përfshijë:
   a. Një përshkrim të plotë të projektit dhe detyrave të kërkimit;
   b. Projekt plan - progresin për përfundimin e komponentit kërkimor;
   c. Ndonjë plan për qëndrimin në universitete të tjera, institucione kërkimore brenda apo jashtë vendit;
   d. Projekt planin e botimeve dhe referimeve sipas kërkesave për përfundimin e komponentit kërkimor (referuar VKM-112, viti 2018).
3. Raportet e progresit përgatiten nga doktorantët në bashkëpunim me udhëheqësin/t e tyre dhe shqyrtohen dhe miratohen çdo vit akademik në referimet vjetore të doktorantëve në njësinë bazë.

Neni 12
Udhëheqja dhe ecuria e studimeve

1. Puna për kryerjen e tezës së doktoratës duhet të kryhet nën drejtimin individual të udhëheqësit me titull "Profesor", "Profesor i asociuar", ose dhe me bashkëudhëheqës me gradën shkencore "Doktor" ("PhD") të marrë në universitete të njohura në BE, SHBA, Kanada.

2. Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur është rasti i ofrimit të programit të studimeve të ciklit të tretë nga më shumë se një njësi universitare) siguron/jnë që studentët të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre.
3. Njësia bazë përgjegjëse duhet të përcaktojë menjëherë një udhëheqës të ri (ose dy) dhe t'ia propozojë dekanatit, në rastet kur:
   a. Udhëheqësi kryesor nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit ose kur do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

b. Marrëdhënia student-udhëheqës nuk funksionon mirë dhe duhet të ndryshojë me kërkesë të studentit ose të udhëheqësit të tij;

4. Zëvendësimi udhëheqësit bëhet brenda dhe jo më vonë se viti i dytë i kërkimit shkencor, me qëllim që ecuria e procesit të mos cënohet.
5. Në të gjitha rastet, studenti duhet të ketë vetëm një pikë të identifikuar kontakti, që duhet të jetë udhëheqësi kryesor i tij/saj. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studenti duhet të dijë se kush do të jetë personi që do ta zëvendësojë.
6. Udhëheqësi dhe studenti duhet të mbajnë kontakte të rregullta. Udhëheqësi është përgjegjës për vazhdimësinë akademiko-kërkimore të studentit dhe duhet të mundësojë pjesëmarjen e rregullt të tij në grupin kërkimor.
7. Takimet ndërmjet udhëheqësve dhe doktorantëve duhet të jenë të dokumentuara gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit në njësinë bazë.
8. Çdo vit duhet të bëhet vlerësimi i studentit nëpërmjet referimeve të hapura në njësinë bazë/grupin mësimor-kërkimor. Në çdo rast njësia bazë/grupi jep konkluzionet e vlerësimit, të cilat mund të përfshijnë dhe pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin e kandidatit nga Doktorata.

Neni 13
Baza didaktike dhe mbështetja teknike

Njësia bazë duhet tu garantojë studentëve të pranuar në programin e Doktoratës:

a) Kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik dhe kërkimor;

b) Vënien në dispozicion të bibliotekës shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike, si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së;

c) mbështetjen teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor;

d) bazë laboratorike të mjaftushme për kërkimet që kanë të nevojshme procedura laboratorike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

PJESA E KATËRT

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I STUDENTËVE

Neni 14
Teza e Doktoratës

1. Vlerësimi përfundimtar i studentëve të Doktoratës duhet të bazohet mbi të gjitha në një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij.

2. Rezultati i kërkimit duhet të paraqitet dhe duhet të ketë formatin e një teze disertacioni. Teza duhet të jetë një pjesë e pavarur e punës shkencore dhe me nivel të lartë akademik në lidhje me formulimin e argumenteve të kërkimit, bazën konceptuale, aspektet teorike, metodologjinë, dokumentimin dhe saktësinë e tij, përdorimin e literaturës dhe prezantimin e punës gjatë mbrojtjes para Jurisë.

3. Teza duhet të kontribuojë në zhvillimin e njohurive të reja teorike kundrejt disiplinës përkatëse dhe të ketë një standard akademik, i cili të justifikojë publikimin si pjesë e literaturës në fushën përkatëse.

4. Rezultati i kërkimit mund të jetë edhe kumulativ, me jo më pak se 3 artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare **me faktor impakti (*Thomson & Reuters*) me koficient mbi 1** (standartet shtetërore të cilësisë, II-5, kriteri 4)

5. Në këtë rast teza duhet të përmbajë dhe një kapitull, i cili të përmbledhë dhe të sistemojë problemet dhe konkluzionet e kërkimit të paraqitura në punët e veçanta dhe që në të njëjtën kohë dokumentojnë koherencën e tezës. Kandidati duhet të jetë autori i vetëm i kësaj pjese të tezës.

6. Studenti është i detyruar të ruajë të dhënat e kërkimit në përputhje me udhëzimet dhe rregulloren e studimeve të UBT-së, duke disponuar të gjitha fletoret me shënime, që ka mbajtur gjatë kryerjes së fazave të kërkimit.

7. Në publikimet shkencore, që janë pjesë e punës së Doktoratës do të përdoret përkatësia e UBT-së dhe mirëkuptimi/marrëveshja për autorësitë midis studentit, udhëheqësit dhe bashkëpunëtorëve të tjerë po të ketë.

8. Kriteret bazë që duhet të plotësojë studenti përpara mbrojtjes së dizertacionit janë: (sipas VKM 112, dt. 23.02.2018).

   a. të ketë realizuar si autor i parë ose dhe i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat, të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) **në ose me** të paktën një nga vëndet e BE, OECD, G-20, të pranuara në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceding", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

b. të ketë botuar së paku 3 (tre) artikuj shkencore në revista shkencore, 2 nga të cilat të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vëndeve të BE-së, OECD-së dhe G20-tës, me bord editorial, ku së paku në njërin të jetë autor i parë dhe në tjetrin edhe autor i dytë, kur autor i parë është udhëheqësi.

c. të ketë realizuar 3 (tre) referime në njësinë bazë, përveç referimit të parë, që i takon metodikës ose metodologjisë së studimit. Në referimin e tretë, përveç të dhënave të vitit të tretë duhet dhe përmbledhja e rezultateve për të gjithë kërkimin.

d. të gjitha referimet dhe botimet duhet të pasqyrojnë aspekte të punës kërkimore që i përkasin zhvillimit dhe realizimit të planit të doktoratës.

e. të ketë përgatitur dhe dorëzuar në departament dizertacionin së bashku me një përmbledhje/autoreferatin të miratuara paraprakisht dhe të firmosura nga udhëheqësi shkencor.

9. Dizertacioni hartohet në gjuhën shqipe dhe duhet ti përmbahet formatit të kërkuar nga Standartet e Cilësisë dhe Rregullores e Studimeve të ciklit të tretë të UBT-së, mbi modelin e tezës, e cila duhet të ketë një përmbledhje (2000-4000 fjalë), në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian, në format të shtypur dhe elektronik, CD.(VKM 112, kriteri 7).

Neni 15
Dorëzimi i tezës dhe ngritja e Jurisë

1. Sapo kandidati i Doktoratës është gati për t'u vlerësuar teza e tij, dosja e doktoratës me kopjet e tezës dorëzohet pranë drejtusit të njësisë kryesore, së bashku me një kërkesë për fillimin e procedurës së mbrojtjes, të firmosur nga kandidati dhe udhëheqësi. Nëse dosja depozitohet, ajo nuk mund të tërhiqet para se të vendoset mbrojtja publike e tezës para Jurisë.

2. Drejtuesi i njësisë kryesore brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e dorëzimit të dosjes në Dekanat, ja përcjell dosjen për vlerësim njësisë bazë. Pas vlerësimit dhe propozimit të Jurisë me 8 (tetë) kandidatë nga njësia bazë, dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për Dhënien e Gradës shkencore "Doktor" brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

3. Në rast se njësia bazë jep vlerësim negativ për dizertacionin/dosjen, kandidati ka të drejtë të riparaqesë dosjen e plotësuar me dizertacionin pas një periudhe jo më shpejt se 3 (tre) muaj (VKM 112, dt.23.02.2018, kreu I, pika 9).
4. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre Jurinë me 5 anëtarë për vlerësimin e disertacionit, 2 (dy) nga të cilët, u përkasin njësive bazë nga institucione homologe vendase ose të huaja.
5. Anëtarët e Jurisë duhet të jenë me titull "Profesor. Në raste të një pamundësie të tillë, të paktën 3 (tre) anëtarë duhet të jenë me titull "Profesor" dhe 2 (dy) anëtarët e tjerë me titull "Profesor i asociuar".
6. Juria e ngritur nga komisjoni i gradës shkencore "Doktor", miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore. (VKM 112, kreu I, pika11).
7. Juria cakton datën e mbrojtjes së dizertacionit brenda 15 ditëve, nga data e miratimit të saj nga Dekani dhe organizon mbrojtjen publike për vlerësimin e tezës së dizertacionit.

Neni 16
Oponentët e Doktoratës

1. Njësia bazë propozon 2 (dy) anëtarë të Jurisësi oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket njësive bazë nga institucione homologe, vendase ose të huaja.
2. Nuk emërohen oponentë ata, të cilët kanë pasur një përfshirje substanciale në punën e studentit të Doktoratës ose puna e të tyre është vetë fokusi i projektit të kërkimit.
3. Oponentët duhet të verifikojnë edhe vërtetësinë e të dhënave të përdorura në disertacion, respektimin e praktikës së punës kërkimore, si edhe citimet bibliografike të punimeve kërkimore dhe artikujve të autorëve të tjerë.
4. Oponentët shprehen qartë për pastërtinë e punimit shkencor nga plagjiatura. Në rast se vërejnë se kjo ka ndodhur, ata kërkojnë ndërprerjen e vlerësimit të disertacionit.
5. Udhëheqësi shkencor i studentit nuk mund të jetë oponent.
6. Është e rekomandueshme që një anëtar i Jurisë të Doktoratës të jetë nga universitete të njohura në botë për cilësi, me veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, me të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe mbi 5 vjet përvojë akademike e kërkimore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

a) programi i studimit të Doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilën prej njësia kryesore përkatëse;
b) fusha e kërkimit të jetë e përafërt;
c) caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin njësi kryesore për studentët që zhvillojnë programe të tilla;
d) vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së Doktoratës;
e) anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilës njësi kryesore;
f) secila njësi kryesore i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi titullin "Doktor" ose ekuivalent me të, duke shënuar në diplomat përkatëse "Tezë Doktorate në bashkëpunim me fakultetin përkatës".

PJESA E SHTATË

STRUKTURA E TEZËS SË DOKTORATËS

Neni 30

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

- Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit në këtë rregullore. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar ai nuk mund të pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit të kërkuar;
- Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, njësisë kryesore, programit të Doktoratës, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes;
- Punimi nuk mund të jetë më e vogël se 100 faqe me madhësi shkrimi 12 (Time New Roman);
- Kopjet e printuara të tezës duhet të jenë në letër format A4, të një cilësie të mirë (21cm x 29.7cm);
- Materiali duhet të shtypet nga dy anët e letrës format të përzgjedhur. Teksti duhet të shtypet me hapësirë 1.0 ndërmjet rreshtave dhe *line spacing option 15pt, ndermjet paragrafeve 6pt.* Masa e shkronjës duhet të jetë 12; first line 0.3;
- **Margjinat** për të gjithë tekstin do të jenë:
  - Margjina e sipërme 1"
  - Margjina e poshtme 1"
  - Margjina e majtë 1.25"
  - Margjina e djathtë 1.25"
- Të gjithë**numrat e faqeve** duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

- **Shënimet** duhen të bëhen **me shkrim Times New Roman, 12, hapësira *single***;
- **Tabelat** të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brënda margjinave të caktuara. Çdo tabele i duhet vendosur një numër referimi që duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. **Fjala "Tabela", numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 10, bold.** Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate referencat duhet të theksohen;.
- **Ilustrimet dhe diagramat** duhet të skanohen dhe të inkorporohen në versionin elektronik të dokumentit. **Fjala "Figura", numri i diagramës që ndjek numrin** e kapitullit të cilit i përket dhe legjenda të vendosen poshtë diagramës apo figurës. **Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 10, bold;**
- **Literatura** e cituar në tekst do të jetëme **mbiemër të autorit dhe të tjerëdhe viti i botimit si këtu (Brayan *et al*, 2006);**
- Krahas materialit të plotë të tezës së Doktoraturës disertanti përgatit një përmbledhje të kësaj teze ose të quajturin "Autoreferat" me rreth 30 faqe e mëshomë A5, e cila do të jete elektronikisht e disponueshme për secilin anëtar të Departametit, Jurisë, KGSHD.

Neni 31

MODELI I TEZËS SË DOKTORATËS

Në faqen e parë shkuhet në pozicionin e mesit dhe me shkrim të qendërzuar (center text): "***Copyright, # I # Emri, Mbiemri i studentit, # Viti***". (*shënim: Shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rreshti të ri*).

- Në faqen e dytë në pozicionin e sipërm shkruhet me shkrim të qendërzuar: **"Udhëheqësi i Emri Mbiemri i Studentit vërteton se ky është versioni i miratuar i disertacionit të mëposhtëm:"** dhe më tej vazhdohet në pozicionin e 1/3 të faqes rishkruhet **Titulli i disertacionit** me germa kapitale dhe shkrim 16, Times New Roman. Më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet në të djathtë **Emri i udhëheqësit shkencor** dhe i **bashkudhëheqësit** (nëse ka) dhe firma.
- Në faqen e tretë në pozicionin e sipërm, me shkrim të qendërzuar rishkruhet **Titulli i disertacionit** me germa kapitale dhe shkrim 16, Times New Roman. Në pozicionin e 1/3 të faqes shkruhet **Përgatitur nga Grada e mëparshme (shkurtim), Emri Mbiemri i studentit**, më poshtë, me hapësirë të trefishtë, shkruhet me shkrim të qendërzuar teksti: "***Dizertacion i paraqitur në # Fakulteti i _____, # Universiteti Bujqësor i Tiranës, # Në përputhje të plotë # Me kërkesat # Për gradën Doktor***. Faqja mbyllet me shkrimin **Universiteti Bujqësor i Tiranës. # Muaji, Viti** (*shënim: Shenja # është përdorur për të treguar fillimin e një rreshti të ri*).

- Në faqen e katërt shkruhet "**Dedikim**", i cili është fakultativ;
- Në faqen e pestë shkruhet "**Mirënjohje/falenderim**", e cila është fakutlative;
- Në faqen e gjashtë shkruhet ky tekst:

Deklaratë mbi origjinalitetin
Emri Mbiemri

Deklaroj se kjo tezë përfaqëson punën time origjinale dhe nuk kam përdorur burime të tjera, përveç atyre të evidentuara nëpërmjet citimeve.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër, duke përfshirë dhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Jam i/e vetëdijshëm (vetëdijshme) se në rast të mospërputhjeve, Senati i UBT-së është i ngarkuar të më revokojë gradën "Doktor", që më është dhënë mbi bazën e kësaj teze, në përputhje me "Rregulloren e Programeve të Ciklit te tretë (Doktoratë) në UBT", dt..... neni 21.

Vëndi, data Firma

- Në faqen e shtatë jepet "**Përmbajtja e lëndës**", e cila duhet të jetë e detajuar: kapitujt, titujt dhe nëntitujt e çdo kapitulli dhe numri përkatës i faqeve. Në vijim jepet "**Lista e tabelave**" dhe "**Lista e figurave**" e shoqëruar me numrat përkatës të faqeve;
- Më pas vazhdohet me kapitujt e disertacionit: "**Hyrja**", "**Materiali dhe Metoda**", "**Rezultatet**", "**Diskutimet**" (ose "**Rezultatet dhe Diskutimet**"), "**Konkluzione**", "**Përmbledhje**", "**Summary**" (në anglisht 10 faqe), "**Literatura**", "**Aneks**" (fakultative). Çdo kapitull ka çështjet dhe nënçështjet e veta;
- **Lloji i shkrimit** sipas niveleve:

  1 **Titulli kryesor** ose Titulli i kapitullit: Times New Roman; Bold; 16, all capital; hanging 0.3; hapësira para dhe pas tij 12;

  1.1 **Niveli i parë**: Times New Roman; Bold; 14; Small capital, hanging 0.4; hapësira para dhe pas tij 6;

  1.1.1. **Niveli i dytë**:Times New Roman; Bold; 14; hanging 0.5; hapësira para e pas tij 6;

  1.1.1.1 **Niveli i tretë**:Times New Roman; Bold dhe italic; 14; hanging 0.6; hapësira para dhe pas tij 6;
- Më tej jepet një **Cv** e shkurtër e autorit, në mënyrë fakultative, e cila nuk duhet të kalojë një faqe.
- **Formatimi i Referencave (Literatura)**

Citimi i revistave:

Kliem H, Berisha B, Meyer H, Schams D: 2009. **Regulatory changes of apoptotic factors in the bovine corpus luteum after induced luteolysis.** *Molecular Reproduction and Development,* **76**(3): 220-230.

Citimi i librave

Lodish HF, Berk A: 2008. **Molecular cell biology**: WH Freeman, pp....

Citimi i kapitujve të librave

Griffiths AJ: 2005. **DNA: Structure and replication**. In: *Introduction to genetic analysis*: ËH Freeman, 920-940.

Citimi i tezave të Disertacioneve

Yetim H: **Biochemical and structural alteration of restructured fish muscle as influenced by egg white tumbling and storage time**. PhD Dissertation.The Ohio State University, Colombus, Ohio, USA. 1993.

Citimi i proceedings të botuara

Podgrabinska S, Braun P, Velasco P, Kloos B, Pepper MS, Jackson DG, Skobe M, 2002: **Molecular characterization of lymphatic endothelial cells**. *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America,* **99**(25): 16069.

Citimi i materialeve të papublikuara

Arat S, Rzucidlo SJ, Stice SL: **Transgenic bovine nuclear embryos from adult somatic cell lines**. *Turk. J. Vet. Anim. Sci.*, In press. or personnal comunication.

Neni 32

Akordimi i titullit "*Doctor Honoris Causa*"

1. Institucionet e Arsimit të Lartë mund të akordojne titullin "*Doctor Honoris Causa*" për figura të shquara të shkencës dhe të shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe të shkencës si dhe në zhvillimin e vëndit tonë në tërësi.

2. Ky titull jepet me vendim të Senatit Akademik të UBT-së, pasi merret pëlqimi i ministrit përgjegjës për arsimin. Numri i titujve "*Doctor Honoris Causa*", që mund të akordojë UBT-ja nuk mund të jetë më shumë se 2 (dy) në vit.

PJESA E TETË
HYRJA NË FUQI DHE ZBATIMI I RREGULLORES
Neni 33

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Rektoriati dhe Senati UBT-së.

2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë studentët që i fillojnë studimet e ciklit të tretë (Doktoratë) pas hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe pas miratimit të akteve nën-ligjore, si VKM-112, dhe udhëzime të ndryshme të ministrit përgjegjës për arsimin si dhe të statutit të UBT-së.

3. Kandidatët e rregjistruar në programet e ciklit të tretë të doktoraturës, para hyrjes në fuqi të VKM-së 112, dhe kësaj rregulloreje, përmbushin kriteret dhe zbatojnë procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në momentin e regjistrimit në programin e ciklit të tretë.

4. Kjo rregullore zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe për një kohë të pacaktuar nga të gjitha strukturat e ngarkuara, dhe njësitë mësimore kërkimore, menjëherë pas miratimit të saj nga Senati Akademik i UBT-së.

5. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje njësitë bazë, njësitë kryesore të UBT-së, Zv/Dekanët e programit të studimeve të ciklit të tretë, Komisionet e Gradave Shkencore të njësive kryesore, Dega e Projekteve, të Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Promovimeve në UBT.

6. Njësitë kryesore mund të hartojnë rregullore të br[nd[shme, duke sjellë në pah specifika në procedurë dhe kërkim, por pa rënë ndesh me përkufizimet e kësaj rregulloreje, që duhet të konsiderohet **"Rregullore Bazë"** dhe të njihet e zbatohet nga të gjitha njësitë mësimore kërkimore të UBT-së.

7. Të drejtën e ndryshimeve në këtë rregullore e ka vetëm Senati Akademik me propozimet përkatëse të Dekanateve të njësive kryesore të UBT-së, Komisionet e Gradave Shkencore dhe Dega e Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Projekteve, konform akteve rregullative të UBT-së.

Konceptoi: *Th. Ruci*
Konfirmoi: *R. Postoli*
Aprovoi: *S. Sulçe*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

7. Kur oponentët kanë përfunduar raportet e tyre, 2-3 ditë përpara mbrojtjes publike, thirren nga dekani i njësisë kryesore bashkë me kryetarin e Jurisë për të rënë dakord për zhvillimin e mbrojtjes publike dhe i dorëzojnë dekanit dhe kryetarit të Jurisë të Doktoratës nga një kopje të raporteve (oponencave) individuale.
8. Vlerësimet e oponentëve përfshijnë dhënien e diplomës për gradën shkencore "Doktor" ose riparaqitjen e punimit kërkimor me shkrim pas plotësimit të rekomandimeve të tyre, zgjatje të mëtejshme të studimeve, ose refuzimin e diplomës për gradën shkencore "Doktor".

Neni 17
Mbrojtja publike e tezës së Doktoratës

1. Koha dhe vendi i mbrojtjes publike shpallen të paktën dy javë më parë nga Zv/Dekani i programit të studimeve të ciklit të tretë. Procedura e mbrojtjes së disertacionit para jurisë është publike.
2. Mbrojtja publike kryesohet nga kryetari i Jurisë dhe zhvillohet sipas kësaj procedure:
   a. Referimi i studentit të Doktoratës, i cili paraqet objektivat dhe rezultatet e punës shkencore gjatë një intervali prej 30-40 minutave;
   b. Leximi i oponencave;
   c. Pyetje dhe diskutime nga juria;
   d. Pyetje dhe diskutime nga të pranishmit. Në këtë rast pjesëmarrësit nga auditori, të cilët kanë dëshirë të komentojnë, duhet të njoftojnë drejtuesin e seancës dhe të bëjnë komente brenda limiteve kohore të përcaktuara nga drejtuesi i seancës;
   e. Vlerësimi i Jurisë.

Neni 18
Vlerësimi i Jurisë mbi Tezën e Doktoratës

1. Gjatë vlerësimit të tezës juria duhet të marrë në konsideratë raportet e oponentëve. Një vlerësim i përgjithshëm duhet bërë mbi pikat e dobëta dhe të forta, duke përfshirë dhe vlerësimin nëse materiali dhe metoda janë relevante për argumentet e ngritura në tezë, si dhe nëse argumentet dhe konkluzionet e arritura janë të forta.

2. Udhëheqësi mund të thirret në takimin e jurisë me qëllim që të informojë mbi udhëheqjen e kandidatit të Doktoratës dhe të punës së tezës.
3. Juria mund t'i kërkojë kandidatit të Doktoratës të paraqesë materialet e tij bazë, si dhe materialet suplementare për të qartësuar me informacione shtesë.
4. Vlerësimi i juries është i fshehtë dhe bëhet me pikë. Secili anëtar ka në dispozicion 20 pikë për vlerësimin maksimal të kandidatit.
5. Sistemi i vlerësimit të punimit të doktoraturës është:

a. Fiton titullin "Doktor" me vlerësim të jurisë "Shkëlqyeshëm" me 95-100 pikë
b. Fiton titullin "Doktor" me vlerësim të jurisë "Shumë mirë" me 85-94 pikë
c. Fiton titullin "Doktor" me vlerësim të jurisë 'Mirë"me 65-84 pikë
d. Fiton titullin "Doktor" me vlerësim të jurisë "Mjaftueshëm" me 50-64 pikë
e. Nuk Fiton titullin "Doktor" me vlerësimin "Pakalueshëm" me më pak se 50 pikë

6. Rezultati përfundimtar i vlerësimit pasqyrohet në proces-verbalin e mbrojtjes së doktoratës dhe më pas shpallet nga kryetari.

Neni 19
Raporti i jurisë mbi tezën e Doktoratës

1. Juria, brënda një jave nga mbrojtja publike, harton raportin e vlerësimit, dhe së bashku me vlerësimin dhe fletët e votimit, e përcjell dosjen në KGSHD.

2. Juria në raportin e vlerësimit që do të paraqesë, duhet të pohoj qartë nëse:
   a. Aprovon mbrojtjen publike të tezës;
   b. Nuk aprovon tezën për mbrojtje publike, por lejon përmirësimin e saj;
   c. Nuk e miraton (hedh poshtë) tezën.

3.Çdo mospajtim midis anëtarëve të jurisë duhet të deklarohet në raport, së bashku me arsyet.

4.Kur midis anëtarëve të jurisë ka mospajtim mendimesh, rasti i bëhet i ditur KGSHD-së, i cili:

   d. Merr vendim për të mos patur vlerësim të metejshëm;
   e. Kërkon sqarime të mëtejshme nga juria;
   f. Cakton dy ekspertë të rinj;
   g. Vendos nëse dy ekspertët e rinj do të përfshihen në juri.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

5. Kur juria konstaton se teza ka mungesa dhe për pasojë, nuk aprovon mbrojtjen publike, ajo mund të lejojë që versioni i përmirësuar i tezës të paraqitet vetëm një herë. Juria duhet të komentojë se cilat pjesë të tezës duhen përmirësuar dhe të përcaktojë afatin final për dorëzimin e tezës së përmirësuar në marrëveshje me kandidatin dhe udhëheqësin.

6. Teza e përmirësuar duhet të paraqitet jo më shpejt se 3 (tre) muaj (VKM 112, dt.23.02.2018, kreu I, pika 9) dhe brenda 6 (gjashtë) muajve (standartet shteterore të cilësisë). Vetëm teza e përmirësuar konsiderohet zyrtare dhe depozitohet në institucione e zyra përkatëse.

7. Nëse juria vendos të rrëzoj tezën e përmirësuar ajo nuk rekomandon riparaqitje të së njëjtës tezë për të bërë një vlerësim të ri. Pra në të gjitha rastet, Juria lejon që teza e përmirësuar të paraqitet vetëm një herë.

Neni 20
Marrja e diplomës për gradën shkencore "Doktor"

1. Pas përfundimit të procedurës së mbrojtjes të doktoratës, Juria brënda 1 (një) jave përcjell dosjen e doktoratës me raportin e vlerësimit dhe vlerësimin e jurisë, Komisionit për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor".

2. KGSHD-ja, brënda 10 (dhjetë) ditëve merr vendimin për dhënien ose jo të Gradës Shkencore "Doktor", dhe ja përcjell dosjen drejtuesit të njësisë kryesore për plotësim të dokumentacionit dhe procedura të mëtejshme.

3. Pas plotësimit të dokumentacionit të dosjes, Dekani me shkresë zyrtare brenda 1 (një) jave e përcjell dosjen tek Dega e Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit Shkencor (Zyrës së Promovimit) të UBT-së dhe kërkon regjistrimin e gradës në regjistrin e UBT-së dhe në atë shtetëror të gradave dhe titujve akademike.

4. Dega e Kërkimit Shkencor të UBT-së, pasi kontrollon ligjshmërinë e dosjes, i relaton Rektorit të UBT-së firmosjen ose jo të gradës shkencore 'Doktor" dhe kërkon regjistrimin e saj si në regjistrin e UBT-së dhe në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademike në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

5. Pas regjistrimit në regjistrin shtetëror të gradave dhe titujve akademike, pranë ZSS bëhet regjistrimi i diplomave të Doktoratave, sipas njësive kryesore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

6. Përmbajtja e dokumentacionit të dosjes është e mirë përcaktuar dhe liston një seri dokumentash të organizuara sipas një skede nga Dega e e Projekteve, Kërkimit dhe Kooperimit shkencor të UBT.-së.

7. Një kopje e disertacionit të studentit që ka marrë diplomën "Doktor" depozitohet në bibliotekën e Universitetit Bujqësor dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare.

8. Dosja e plotë e studentit të Doktoratës së bashku me një kopje të tezës së Doktoraturës dhe autoreferatin depozitohen në Degën e Kërkimit Shkencor dhe arshivohet për 5 vjet dhe më pas transferohen në arshivën e UBT-së.

9. Diploma për gradën shkencore "Doktor" nuk lëshohet, pa u depozituar në institucionet e lartpërmëndura disertacioni botuar në letër dhe në disk (CD) dhe pa u bërë publik në faqen zyrtare të UBT-së.

10. Dega e Kërkimit Shkencor e UBT-së përgatit diplomën e gradës shkencore "Doktor", e cila firmoset nga Dekani i njësisë kryesore përkatëse dhe Rektori i UBT-së, dhe tërhiqet në ditën akademike, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

11. Në diplomën e gradës shkencore "Doktor" shënohen: numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduar më parë, nr. i Masterit të Shkencave ose DIND-së, numri i diplomës së gradës shkencore "Doktor" (sipas shkresës së Rektorit me nr. Prot. 1491 dhe vendimit të Senatit nr. 35, dt. 15/09/2014).

Neni 21
Revokimi i gradës "Doktor"

1. Grada shkencore "Doktor" është e revokueshme në çdo kohë dhe në çdo rast kur konstatohet plagjiaturë ose manipulim të dhënash në punimet e kandidatit. Në këtë rast dekani i kërkon KGSHD të mblidhet menjëherë dhe të shqyrtojë rastin e konstatuar.

2. Vendimi përfundimtar merret nga Komisioni i Doktoratës dhe Komisioni i Etikës i Senatit të UBT-së, të cilat i propozojnë Rektorit të UBT-së revokimin e gradës shkencore "Doktor", të fituar padrejtësisht nga kandidati, bazuar në gjykimin dhe relatimin e KGSHD-së të njësisë kryesore përkatëse.

3. Rektori, pasi e shqyrton rastin, merr vendim për tu bërë çregjistrimi i gradës nga regjistri përkatës i UBT-së dhe nga regjistri shtetëror i gradave dhe titujve akademike në ministrinë përgjegjëse për arsimin, rininë dhe sportin.

4. Të drejtën e revokimit të gradës shkencore "Doktor" e ka UBT edhe në rastet kur konstatohet plagjiaturë apo manipulim të dhënash në studime/punime kërkimore të kryera, pas promovimit për marrjen e gradës së lartpërmëndur.

5. Të gjithë palët e përfshira në procesin e studimeve të ciklit të tretë (Doktoratës) duhet t'i referehen rregullores së UBT-së mbi etikën në kërkimin shkencor.

PJESA E PESTË

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMIISTUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË

Neni 22
Administrimi dhe financimi

1. Njësia që organizon programin e studimeve të ciklit të tretë duhet të ketë në dispozicion asete dhe mjedise administrative të mjaftueshme për të realizuar mirëfunksionimin e programit e studimeve të doktoraturës.
2. Organet përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të Doktoratës janë KGSHD-të e njësive kryesore, Zv/Dekani i Programit të studimeve të Doktoratës, njësia bazë/njësia kryesore, ku është atashuar studenti i Doktoratës dhe udhëheqësi i doktorantit.
3. Shpenzimet për kryerjen e Doktoratës planifikohen dhe mbulohen nga projekte të ndryshme kërkimore të mbështetura nga ministria (Ligji AL, 80/2015, neni 79, pika 1), nga projektet kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare të përftuara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh, nga tarifa e regjistrimit dhe e shkollimit tëkandidatit, nga shërbime për të tretë,që bëjnë njësitë bazë si dhe sponsorizime oseburime të tjera publike e private, apo edhe me vetëfinancim nga doktorantët (Ligji AL, 80/2015, neni 79, pika 5).
4. Tarifa e studimeve në programin e ciklit të tretë do të jenë përkatësisht 5 mijë për regjistrim dhe 100 mijë lekë në vit për vazhdimin dhe realizimin e doktoratës.

Neni 23
Internacionalizimi i programit të studimeve të Doktoratës

1. Në shkollën e Doktoratës në kuptimin e internacionalizimit të programeve të doktoraturës mund të regjistrohen studentë doktorantë që vijnë

a. nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare;

b. nga rajoni i Ballkanit;

c. nga vëndet e BE-së;

d. nga vënde të tjera të botës.

2. Programi i studimeve të Doktoratës duhet tëinkurajojë mobilitetin e doktorantëve, duke marrë përsipër një masë të shpenzimeve:

   a. për formim akademik jashtë programit të studimeve të Doktoratës;

   b. për prezantimin e rezultateve të kërkimit në veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres).

3. Njësia, që organizon programin e Doktoraturës,duhet të ketëmarrëveshje, së paku, me një universitet perëndimor që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve të Doktoratës, si dhe realizim të projekteve kërkimore të përbashkëta.

4. Programi i studimeve të ciklit të tretë mund të parashikojë edhe zhvillimin e disa moduleve speciale në studime të thelluara teorike në fushën përkatëse të kërkimit.

Neni 24

Përgjegjësitë e Njësisë Bazë për Studentët e Doktoratës

Përgjegjësi i njësisë bazë/njësia kryesore, ku atashohet studenti për kryerjen e studimeve të Doktoratës, ka për detyrë:

1. Të kujdeset për çështjet që lidhen me studentët e ciklit të tretë dhe për komunikimin me udhëheqësin dhe Zv/Dekanin e Shkollës së Doktoratës.
2. Të njohë doktorantët e rinj me rregulloret dhe kërkesat e tjera të UBT-së për shkollën e Doktoratës.
3. Të diskutojë mbi stadet ku duhet të kalojë doktoranti drejt përfundimit të tezës.
4. Të sigurojë që fusha e kërkimit të jetë brenda ekspertizës metodologjike dhe teorike të udhëheqësit.
5. Të sigurojë se njësia bazë ka kapacitetet e mjaftueshme për të udhëhequr doktorantët deri në fund të programit. Nëse udhëheqësi largohet apo mungon për një periudhë mbi tre muaj, njësia bazë duhet të marrë masa për një udhëheqës alternativose bashkëudhëheqës, të pranueshëm për doktorantin.
6. Të monitorojë progresin e doktorantit, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me udhëheqësin, si dhe të sigurojë raportimet e rregullta gjatë gjithë periudhës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

7. Të sigurojë një mjedis të përshtatshëm intelektual dhe fizik për të gjithë studentët. Studentët duhet të inkurajohen të marrin pjesë në seminare shkencore dhe t'u krijohen të gjitha mundësitë që të bëhen një pjesë integrale e mjedisit shkencor të njësia bazë, grupit kërkimor dhe disiplinës.
8. Të organizojë sesione për studentët e Doktoratës, në mënyrë që ata të realizojnë referimet e parashikuara në këtë rregullore. Ai duhet t'i informojë doktorantët për natyrën e kërkimit shkencor në fushën e veçantë, mbi fasilitetet e disponueshme brenda njësisë bazë, si dhe programin e njësia bazë për seminaret/referimet e doktorantëve.
9. Të zgjidhë problemin, në rast se marrëdhënia udhëheqës/doktorant prishet, dhe të gjejë alternativa të tjera për përmirësim ose zëvendësimin të udhëheqësit.

Neni 25
Përgjegjësitë e udhëheqësit shkencor

1. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së Doktoratës.
2. Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.
3. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të kërkimit.
4. Të japi ndihmesën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të informacionit, konsulencën për mbajtjen e shënimeve dhe përgatitjen e punimit.
5. Udhëheqësi ka përgjegjësi të ndërgjegjësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.
6. Të mbajë takime të rregullta me studentin mbi ecurinë e punimit.
7. Në rastet e bashkudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.
8. Të vlerësojë rregullisht progresin e studentit, duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit.
9. Të vetëdijësojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
10. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e prezantimeve në seminare ose takime të ndryshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË

11. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.
12. Të nxisë studentin që ai të marrë pjesë në konferenca dhe të botojë pjesë nga kërkimi i tij, duke respektuar marrëveshjen e autorësisë.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrat e studentit

1. Kryerja e Doktoratës mund të konsiderohet si një bashkëveprim tre-faktorial: midis njësia bazë përkatës, udhëheqësit dhe studentit. Ndërkohë që njësia bazë dhe udhëheqësi pritet të sigurojnë mjaft forma për mbështetje dhe drejtim, përgjegjësia e fundit për menaxhimin e projektit dhe marjen e gradës "Doktor" i takon kandidatit.
2. Kandidatët duhet të njihen dhe të zbatojnë rregullat, rregulloret e UBT-së dhe kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me doktoratën në UBT.
3. Përmes sesioneve orientuese të mbajtura në departament ose nëpërmjet konsultimeve me udhëheqësin, kandidati, që në fillimet e tij, duhet të familjarizohet shpejt me:
   a. Natyrën dhe kufizimet e kërkimit të doktoratës;
   b. Fasilitetet (duke përfshirë këtu mbështetjen për punën në terrren, nëse është e nevojshme), që studentit i vihen në dispozicion në departament, fakultet dhe në Universitet;
   c. Përmasat e projektit të kërkimit, kornizën kohore për përfundimin e tij dhe stadet normale që ndeshen gjatë rrugës;
   d. Cilësitë dhe aftësitë që pret Universiteti përmes diplomimit të tij dhe me ndihmën dhe mbështetjen e udhëheqësit të përgatisë një plan për përftimin e aftësive të reja gjatë rrugës së tij të kualifikimit
4. Që në stadet e fillimit, studenti duhet të këshillohet me udhëheqësin në intervale të rregullta dhe të përshtatshme kohore, ashtu siç kanë rënë dakord reciprokisht. Kandidati duhet ta informojë udhëheqësin mbi aktivitetin e kërkimit, progresin e tij, botimet dhe probleme të tjera që i kanë dalë.
5. Në muajt e parë të fillimit të pjesës kërkimore të studimeve të Doktoratës kandidati duhet të dorëzojë për miratim në departament një raport informus për kërkimin, të përgatitur në bashkëpunim me udhëheqësin.

6. Studenti duhet t'i paraqesë udhëheqësit të tij çdo vit të paktën një pjesë të rëndësishme të punës së shkruar (në formë raporti, drafti të një kapitulli, etj.). Studenti dhe udhëheqësi duhet të bëjnë një vlerësim madhor të punës së kryer të paktën çdo gjashtë muaj.
7. Studenti mund dhe duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të lidhura ngushtë me fushën specifike, në të cilën ndjek studimet e Doktoratës
8. Studentët mund dhe duhet të marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara të Doktoratës jashtë punës së tyre kërkimore. Një doktorant duhet të jetë i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në ligjërata, seminare, debate ndërdisiplinare të organizuara në kuadër të programit të studimit të Doktoratës, apo dhe prezantimeve post-doktorale dhe projekteve kërkimore, madje edhe kur këto aktivitete nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të doktorantit.
9. Studenti mund dhe duhet të angazhohet në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të parë, p.sh. në seancat e praktikave, seminareve apo si asistentë lektorë, në mbështetje të profesorëve udhëheqës.
10. Gjatë periudhës për përgatitjen e tezës studenti duhet të ketë paraysh:
    a) të familjarizohet me literaturën në fushën e tij të veçantë dhe ta vlerësojë atë në mënyrë kritike;
    b) të formulojë qartë hipotezën e studimit ose një argument tjetër më të përgjithshëm për rezultatet e tij, të mbështetura me komente, me të dhëna dhe analiza adekuate dhe bashkëkohore;
    c) t'i kushtojnë vëmëndje të veçantë prezantimit përfundimtar të tezës, zakonisht me Power Point. Versioni përfundimtar jo vetëm që duhet të kontrollohet me kujdes për gabimet, por duhet të strukturohet qartë dhe të jetë lehtësisht i kuptueshëm para Jurisë;
11. Gjatë shkrimit të tezës kandidatët duhet të shmangin:
    a) manipulimin e të dhënave, duke paraqitur rezultate që nuk janë marrë asnjëherë;
    b) falsifikimin apo modifikimin e rezultateteve për të konfirmuar hipotezën;
    c) plagjiaturën, duke përfshirë këtu kopjimin direkt të materialeve, përdorimin e të dhënave apo ideve nga njerëz të tjerë, pa përdorur përkatësinë e duhur apo pa i referuar në citimet bibliografike;
    d) përfshirjen e të tjerëve, të cilët në fakt nuk kanë kontribuar në kërkim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

Neni 27
Përgjegjësitë e Zv/Dekanit të Programit të Studimeve të Ciklit të Tretë

1. Të ndjekë procedurën e pranimit të dosjeve të kandidatëve për regjistrimin në Programin e Studimeve të Ciklit të Tretë.
2. Të kryejë seleksionimin paraprak të dosjeve dhe të raportojë pranë dekanatit/Dekanit të njësisë kryesore.
3. Të përgatisë dosjet e kandidatëve në aplikim për shqyrtim dhe t'ua dorëzojë komisioneve "*ad-hoc*" pranë njësive bazë pas miratimit nga dekani.
4. Të relatojë dosjet e percjella nga njësitë bazë me propozimet përkatëse pranë Komisionit të gradave shkencore të njësisë kryesore (KGSHD).
5. Të koordinojë punën e komisioneve "ad-hoc", njësive bazë me KGSHD-në dhe të hartojë materialin përfundimtar për t'u miratuar në dekanat.
6. Të përgatisë listën e kandidatëve fitues.
7. Të grumbullojë ankimimet e kandidatëve dhe t'i relatojë ato Dekanit.
8. Të kryejë regjistrimin përfundimtar në regjistrin themeltar të Doktoratës për çdo kandidat fitues me udhëheqësin shkencor dhe temën përkatëse.
9. Të ndjekë kualifikimet specifike për çdo doktorant sipas drejtimit të studimit në bashkëpunim me shefat e njësive bazë dhe udhëheqësit shkencore.
10. Të koordinojë punën me përgjegjësit e njësive bazë përkatëse dhe të bashkëpunojë me udhëheqësin përkatës të çdo doktoranti për ecurinë e punës gjatë Doktoraturës.
11. Të hartojë grafikun e prezantimeve të punës shkencore të doktorantëve dhe t'i bëjë ato publike në koordinim me përgjegjësit e njësive bazë.
12. Të shqyrtojë raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësi/t kanë kontakt të rregullt me studentët. Kur konstaton probleme i propozon dekanit ndryshimet e nevojshme.
13. T'u bëjë studentëve të njohur të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj., që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.
14. Të kontrollojë plotësimin e kritereve të dosjes përfundimtare të doktorantit së bashku me disertacionin e përfunduar, si dhe të ndjekë procedurën për miratimin nga dekani.
15. Të përcjellë dhe të paraqesë për miratim dosjen pranë Komisionit të Gradave Shkencore të njësisë kryesore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI BUJQËSOR - TIRANË

16. Të ndjekë dhe të zbatojë kriteret e afateve kohore për përfundimin e Doktoraturës sipas kësaj rregulloreje.
17. Të krijojë një data-base për gjithë veprimtarinë e Doktoraturës, me qëllim që të shërbejë si informacion ndërmjet të tjerave dhe për planifikimin dhe koordinimin e punës shkencore në vazhdimësi në rang fakulteti.

PJESA E GJASHTË

STUDIMET E PËRBASHKËTA, MOBILITETET DHE MBËSHTETJA FINANCIARE E STUDENTËVE TË DOKTORATËS

Neni 28
Veçoritë e organizimit të procesit të miratimit të programeve të përbashkëta të Doktoratës

1. UBT mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të Doktoratës me një ose më shumë universitete ose fakultete të tjera në bazë marrëveshjesh, duke pasur parasysh si më poshtë:
   a) programi i studimit dhe përgatitja e tezës së saj të kryhen me periudha të alternuara në secilin nga universitetet/njësia kryesore pjesëmarrëse;
   b) caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin universitet/fakultet për studentët që zhvillojnë programe të tilla.
   c) vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së Doktoratës;
   d) anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të drejtuesve të secilit universitet/fakultet;
   e) secili universitet i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi gradën "Doktor" ose ekuivalent me të, duke shënuar në diplomat përkatëse "Tezë doktorate në bashkëpunim me universitetin.....".

Neni 29
Veçoritë e organizimit të procesit të miratimit të programeve ndërdisiplinore të Doktoratës

1. Njësia kryesore e UBT-së mund të organizojnë programe ndërdisiplinore të studimit të Doktoratës me një ose më shumë fakultete të tjera, duke pasur parasysh si më poshtë: